Pas sherrit në TikTok 'plasi' arma/ 25-vjeçari që plagosi 2 të rinjtë, shok i reperit Cllevio, zbardhen identitetet

15 Prill, 2023 10:08

Madhësia e tekstit:

Detaje të reja në lidhje me sherrin që nisi në rrjetin social 'TikTok' dhe që përfundoi me dy të lënduar me armë zjarri. Gazetarja Klodjana Haxhiaj ka siguruar për **BalkanWeb** identitetet e personave të përfshirë në konflikton me armë zjarri.

Ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit, rreth orës 01:15, në lagjen nr. 10, dyshohet se për shkak të një konflikti në rrjetin social TikTok, autori Klajdi Mansaku, 25 vjeç, shok i reperit Cllevio Serbiano ka qëlluar me armë zjarri, dhe si pasojë, janë dëmtuar lehtë shtetasit Jurgen Vrioni, 21 vjeç, dhe Arben Haxhiu, 21 vjeç, të dy banues në lagjen nr. 12, Durrës.

Nga veprimet e para hetimore rezulton se autori i dyshuar, shtetasi Klajdi Mansaku, rreth orës 22.50, të mbrëmjes së djeshme ka debatuar në telefon me shtetasin Mario Vrioni, (kushëri i shtetasit Jurgen Vrioni) dhe i ka lënë takim për t'u sqaruar në afërsi të banesës së shtetasit Mario Vrioni. Nga policia mëson se Mario Vrioni është me precedent penal për narkotikë dhe Drejtim automjeti pa leje drejtimi.

Ky i fundit pasi ka marrë kushëririn e tij shtetasin Jurgen Vrioni, dhe shtetasin Arben Haxhiu, (shok i përbashkët i tyre) ka shkuar në vendin ku e kishin lënë për tu sqaruar me shtetasin Klajdi Mansaku. Mansaku, sapo ka paré që këta shtetas janë afruar, ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të makinës së shtetasit Mario Vrioni, dhe është larguar menjëherë.

Si pasojë, (dyshohet nga plumb rikoshet) janë lënduar lehtë shtetasi Jurgen Vrioni, i cili pas ndihmës mjekësore ka dalë nga spitali, dhe shtetasi Arben Haxhiu, që aktualisht po merr ndihmë mjekësore dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë po vijon punën për dokumentimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.
Ndërkohë nga shërbimet e Policisë janë ngritur pika kontrolli, në akset rrugore, janë njoftuar pikat e kalimit kufitar, dhe po ushtrohen kontrolle në banesa e ambiente ku dyshohet se mund te fshihet 25-vjeçari me qëllim kapjen e tij.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Cllevio | Durres | plagosje | sherri | shoka i reperit

TË NGJASHME

"Më shkakton gjendje ankthi dhe frikë", Noizy denoncon Cllevion, ndalohet në Rinas reperi
16 Prill, 2023

Ishte kthyer në tmerrin e pronarëve të makinave, iu thyente shamat dhe merrte sendet personale, arrestohet 44-vjeçari në Durrës
16 Prill, 2023

Taboola Feed

If you have nail fungus, do this immediately
Eelhoe · Sponsored
Get Offer

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Cookie Stop · Sponsored
Play Now



Kreu marrëdhënie seksuale brenda "Big Brother VIP", volejbollistja i jep fund lidhjes me këngëtarin e njohur
Kreu marrëdhënie seksuale brenda "Big Brother VIP", volejbollistja i jep fund lidhjes me këngëtarin e njohur
balkanweb.com

You will never turn off your computer again. No Install. Play for free.
PassmarkRank · Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

U kap me 113 mijë euro në makinë, gjykata liron nga burgu efektivin e RENEA-s Altin Morina
16 Prill, 2023

VIDEO/ 24 orë me Policinë Rrugore në Tiranë, "jeshilët" në 'luftë' me Maseratin te Unaza në Farkë
Iyli Çelmeta | 16 Prill, 2023

Mori peng bashkëjetuesen dhe e dhunoi për një javë, përfundon në pranga i ri në Tiranë, ni banesë iu gjet... (Emri)
16 Prill, 2023

Lajoi malira kontrabandë kundrejt rydhëtët, arrestohet doganieri në Vlorë
16 Prill, 2023

Ishte shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentativë, arrestohet në Korfuz 38-vjeçari shqiptar
16 Prill, 2023

U mbajt peng për një javë nga bashkëjetuesi, 28-vjeçarja i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale pas dhunës barbare
16 Prill, 2023

KATEGORIA VIDEO

Pashkët Ortodokse/ Meta dhe Kryemadhi shprehin mesazhet e tyre: Momenti për kapërcimin e dhimbjes dhe lulëzimin e shpresës
16 Prill, 2023

VIDEO/ 24 orë me Policinë Rrugore në Tiranë, "jeshilët" në 'luftë' me Maseratin te Unaza në Farkë
Iyli Çelmeta | 16 Prill, 2023

"Drita e Pashkës ndriçofshi mendjen dhe jetën e shqiptarëve", Presidenti Begaj uron festën nga Korça
16 Prill, 2023

Veliaj nga Shëngjergji: Do vijojmë të ecim përpara me investimet, këtë mandat mbulojmë edhe fshatin më të fundit
16 Prill, 2023

U mbajt peng për një javë nga bashkëjetuesi, 28-vjeçarja i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale pas dhunës barbare
16 Prill, 2023

"Në këtë betejë elektorale të pazakontë për të rrajtur drejtësinë e PD", Bardhi në Lezhë: Në 2009 e mbushëm me pushtet Metën që solli në 2013 Ramën
16 Prill, 2023

BW | Get it on Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

Finlandë, nis punën reaktori më i madh bërthamor në Evropë
16 Prill, 2023

"Më shkakton gjendje ankthi dhe frikë", Noizy denoncon Cllevion, ndalohet në Rinas reperi
16 Prill, 2023

Skandali qeveritar me Elira Kokurën/ Mandia: Ka pasur konflikt interesi, të hetohet shpërdorimi i detyrës
16 Prill, 2023

"Më mirë pak dhe saktë", "Albeaj dhe Bejko takim me mbështetësit: Të dëstancohemi nga gjurmët e bërësja të së shkuarës korruptive
16 Prill, 2023

U kap me 113 mijë euro në makinë, gjykata liron nga burgu efektivin e RENEA-s Altin Morina
16 Prill, 2023

Akuizitori i Irkshëm me makinë, Laciu tregon situatën shqetësuese të Imobiles: Ka frakturë në...
16 Prill, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.